



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

**P. nr. 216/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**-Departamenti i Përgjithshëm, me Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe me zyrtaren ligjore Flutur Nagavci , në lëndën penale kundër të akuzuarit B.Q. nga fsh. D. K Gj. , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1-1.4 të KPRK-së, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti–Përgjithshëm në Gjakovë, PP/II.nr.186/18 të dt. 20.03.2018, duke vendosur në lidhur me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, **me dt.02.08.2018**, murr këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP/II.nr.186/18 e dt.20.03.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

I akuzuari:

**B.Q.** , i biri i S., data e lindjes ... në fsh. D. , K Gj., ku edhe tani jeton ,ka te kryer shkollën fillore ,bukëpjekës i martuar ,i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. ID.....

**Ë s h t ë f a j t o r**

**Sepse :**

**-Me dt.17.11.2017, rreth orës 12.40 min,** në Gjakovë , ne ambulancën ‘E. D. ’,i shkakton lëndim të lehtë trupor te cilat rezultojnë me dëmtim te përkohshëm për shëndetin e te dëmtuarit Sh.H. ,në atë mënyrë qe pasi i pandehuri kishte dërguar vajzën në ambulancë ,ju kishte drejtuar te dëmtuarit me fjalët ‘pse po i fik dritat’ atëherë i dëmtuari ju ka përgjigjur se këtë punë e kam dhe e kishte shtyre ,atë menjëherë mes tyre ka filluar një fjalosje verbale për një moment i pandehuri e sulmon duke e goditur me grushte ne koke ,me ç’ ka te dëmtuarit i shkakton lëndime te lehta trupore te cilat lëndime me gjerësisht janë te konstatuara dhe te përshkruara hollësisht ne ekspertizën mjekoligjore te dt.07.03.2018, nga eksperti mjeko-ligjor Dr. N.H.

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1-1.4 të KPRK-së.**

Andaj ,Gjykata konform nenit 4,41,43, 46,73 dhe nenit 188 par.1-1.4 te KPRK-së ,si dhe nenit 495 te KPPK-se ,të akuzuarin B. Q. e

## GJYKON

Me dënimin me gjobë në shumë prej **200, 00 € (dyqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë , së këtij Aktgjykimi -Urdhër ndëshkimor, në kërcënim të përmbarimit me dhunë .

I dëmtuari Sh. H. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPRK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 49 par.4 të KPPK-së , do t'i zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **10(dhjetë )ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20,00 € (njëzet) euro**.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **20.00 euro** ne emër te ekspertizës mjeko ligjore dhe ne emër te paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej nga **30,00 euro**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

## A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP/II.nr.186/18 të dt. 20.03.2018, ndaj të akuzuarit B.Q. nga fsh. D. K Gjakovë, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1-1.4 të KPRK-së .

Komfor nenit 493 te KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdhër ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjyqimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës se nenit 188 par 1-1.4 të KPRK-së e cila dispozitë për kryesit e kësaj vepre penale parasheh dënim me gjobë apo me burgim gjerë ne 1(një) vjet .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjyqimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- kallëzimi penal me nr. 2017-EA-1263 dt. 28.01.2018,
- deklarata e te dëmtuarit Sh.H. ,dhënë ne st.policor me dt.17.11.2017,
- deklarata e te pandehurit B.Q. , dhënë ne st.policor me dt.,17.11.2017
- raporti i oficerit PK 8623 te dt.17. 11.2017
- raporti i emergjencës spitalit rajonal “I. G.” me nr. 15875,dt.17.11.2017
- ekspertiza mjekoligjore e Dr. N.H. ,mbi natyrën e lëndimeve trupore e dt.07.03.2018

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 të KPK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj personat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 të KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale u murr konform nenit 450 par. 2 pika 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË**  
**P.nr.216/18 të dt. 02.08.2018**

**Sekretarja Juridike :**  
**Flutur Nagavci**

**Gjyqtarja**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës Gjyqtares të kësaj Gjykate. Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.